



ELIZABETH GREICH

(MALTA)

Elizabeth Grech është përkthyesë autodidakte (frëngjisht-anglisht) dhe bashkëpunon me disa shkencëtarë sociale, OJQ si dhe shoqata kulturore dhe artistike. Ajo është konsulente pranë CIHEAM-it

(Qendra Ndërkombëtare për Studime të Përparuara Mesdhetare Agronomike) dhe e ngarkuar me versionin anglisht të dokumenteve të tyre të punës dhe botimeve të tyre. Ajo është edhe përkthyesë letrare dhe përkthen në frëngjisht veprën e disa poetëve/shkrimtarëve bashkëkohorë maltezë, duke përfshirë poetët John Aquilina, Clare Azzopardi, Norbert Bugeja, Antoine Cassar, Adrian Grima dhe John Portelli. Shumë prej përkthimeve të saj u botuan si libra, në përmbledhje poezie ose në revista letrare. Ka shkruar poezi në gjuhën malteze për 15 vitet e fundit, por ka filluar vetëm para pak kohe t'i ndajë. Disa prej tyre u botuan në përmbledhje poezie dhe gazeta, dhe shumë shpejt do të botojë librin e saj të parë me poezi në një shtëpi botuese të njohur në Maltë. Ka marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë në Sidi Bou Said, Tunizi, në qershor 2018 dhe do të marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë në Tetovë, Maqedoni, në tetor 2018.

DASHURI TË TJERA

Nga Philippe tek Alberti

I biri, ai është sekreti i të atit,
kështu thotë një proverb arab.
Por edhe mund të jetë
i ati, që është sekreti i të birit.
Këtë ai të tha ty.

Heshtja përhapet
midis babait dhe djalit.
Atje sundon distanca e dashurisë.

Është sizmike, vdekje.
Një cefël të frymëmarrjes
e mbyll me krisma,
pa marrë parasysh që dridhjet
të kanë paralajmëruar.

Mungesa e mbush zbrazëtinë.
Por mos ki frikë,
ka dashuri të tjera, hapur.
Këtë ai të tha ty.

ISHUJ

Merrmë me ty
për të hekurosur rrudhat,
për të qepur lotët
në Mesdhe.
Në qoftë se ka hapësirë për mua,
më le të tretem
nëpër plasat tejet të holla
të mishit tënd.
Dhe më le të lidh,
të var
një gjerdan dafine
midis ishullit tënd
dhe timit.
Eja,

pusho kokën tënde
mbi supin tim,
nis në lundrim mendimet e tua
mbi aromën
prej kedre
nga gërshetat
që thure në flokët e mi.

VJESHTË

Një pas një
petalet e zbehta të trëndafilit
nga pema në anën tjetër të rrugës
shpien mbi një frymë të erës
aq të brishta si ditët
që të mbeten për t'i numëruar.
Do t'i mblidhja në prehrin tim
t'i grumbulloj si përkujtesë
të erës sate,
por era nis një luftim,
era është më e fortë se unë dhe
një
pas
një
petalet e zbehta të trëndafilit rrëshqiten
midis gishtërinjve të mi.



E kuqja tradicionale 14.3. Vaj në pëlhurë. 40 x40 2014